



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**ZYRA E AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM**

**Nr. i Dokumentit: 22.15.1-2013-08**

**RAPORTI I AUDITIMIT**  
**PËR PASQYRAT FINANCIARE TË KOMUNËS SË SUHAREKËS**  
**PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2013**

**Prishtinë, Qershor 2014**

Zyra e Auditorit të Përgjithshëm (ZAP) kryen auditime të rregullsisë dhe të performancës. Auditori i Përgjithshëm, Lage Olofsson, është kreu i ZAP-it, i cili ka rreth 145 të punësuar. Auditori i Përgjithshëm dhe ZAP janë të pavarur dhe çertifikon rreth 90 Pasqyra Vjetore Financiare çdo vit, ndërsa mund të ndërmarr edhe forma të tjera të auditimit.

Misioni ynë është që të kontribuojmë në menaxhim të shëndoshë financiar në administratë publike. Ne do të kryejmë auditime cilësore në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit të sektorit publik dhe praktikat e mira evropiane. Ne do të ndërtojmë besim në shpenzimin e fondeve publike. Ne do të luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe palëve tjerë të interesit në rritjen e llogaridhënies publike.

Raportet e nxjerra nga ZAP promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien pasi që ato ofrojnë bazë për ti kërkuar llogari menaxherëve të çdo organizate buxhetore.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit dhe raportin mbi Pasqyrat Vjetore Financiare të Komunës së Suharekës në konsultim me Ndhmës Auditorin e Përgjithshëm, Qerkin Morina, i cili e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti dhe opinionin i lëshuar janë rezultat i auditimit të kryer nën menaxhimin e Drejtorit të Auditimit, Florim Beqiri, i mbështetur nga, Mehmet Muçaj (Udhëheqës Ekipi), Qëndresa Sogojeva dhe Evetar Zeqiri.

## TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme .....	4
1 Fushëveprimi i auditimit dhe metodologjia .....	8
2 Pasqyrat vjetore financiare dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm .....	9
3 Rekomandimet e vitit paraprak .....	14
4 Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli .....	15
Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZAP .....	27
Shtojca II: Rekomandimet e vitit paraprak.....	30

## Përmbledhje e përgjithshme

### Hyrje

Ky raport përmbledh çështjet kryesore që dalin nga auditimi ynë i Pasqyrave Vjetore Financiare të komunës së Suharekës për vitin 2013 – i cili e përcakton Opinionin e dhënë nga Auditori i Përgjithshëm. Falënderojmë Kryetarin e Komunës dhe stafin e tij për ndihmën e tyre gjatë procesit të auditimit.

Ekzaminimi i Pasqyrave Vjetore Financiare për vitin 2013 u ndërmorr në përputhje me Standardet e njohura Ndërkombëtare të Auditimit të Sektorit Publik. Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat ne menduam se ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me pasqyrat financiare. Qasja e ndërmarrë është paraqitur në Memon e Planifikimit të Auditimit, të datës 11.11.2013.

Auditimi ynë është fokusuar në:

- Pajtueshmërinë me kornizën e raportimi dhe rreziqet domethënëse për Pasqyrat Vjetore Financiare të theksuara në Memon e Planifikimit të Auditimit;
- Veprimet e ndërmarra ndaj rekomandimeve tona për vitin 2012 dhe atyre të mëhershme; dhe
- Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin e Brendshëm të Komunës së Suharekës (duke përfshirë menaxhimin dhe ekzekutimin e buxhetit).

Niveli i punës së kryer nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm (ZAP) për të përfunduar auditimin për vitin 2013 pasqyron drejtpërsëdrejti cilësinë e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti.

## Opinion

Shtojca I shpjegon llojet e ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ana e Zyra e Auditorit të Përgjithshëm.

Opinion i Auditorit të Përgjithshëm është:

Sipas opinionit tonë Pasqyrat Vjetore Financiare *prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë*, në të gjitha aspektet materiale.

Si *Theksim i çështjes* Regjistri i Pasurive Fikse ende nuk është i besueshëm dhe i saktë për arsye se 5,147,283€, projekte të kontraktuara nga niveli qendror ishin regjistruar nga komuna vetëm në bazë të njoftimit për dhënie të kontratës pa pasur informacione për përfundimin e projekteve. Po ashtu komuna kishte bërë keq klasifikim të shpenzimeve ku nga kategoria e investimeve kapitale kishte paguar për mallra dhe shërbime vlerën prej 291,297€ dhe për subvencione vlerën prej 195,086€. Llogaritë e arkëtueshme ishin të mbivlerësuara për 131,000€. Regjistri i pasurive fikse, llogarive të arkëtueshme dhe keq klasifikimi ekonomik i shpenzimeve nuk ka ndikim në ndonjërin prej dy Pasqyrave Vjetore Financiare ('Pranimet dhe Pagesat në Para të Gatshme' dhe 'Krahasimi i Buxhetit me Shumat Aktuale') në pajtim me SNKSP në bazë të kontabilitetit të parasë së gatshme.

**(SNISA 200 Opinion i Pamodifikuar me theksim të çështjes).**

## Konkluzioni i përgjithshëm

Bazuar në detajet e paraqitura në secilën pjesë të këtij raporti, konkluzioni ynë i përgjithshëm është se:

Menaxhmenti i Komunës nuk kishte dizajnuar një sistem efektiv të kontrollit të brendshëm, dhe kontrollet aktuale të vendosura kishin funksionuar dobët gjatë vitit 2013. Në veçanti ne identifikuan:

- Edhe pse Pasqyrat Vjetore Financiare kishin adresuar shumicën e kërkesave për prezantim, Pasqyrat Vjetore Financiare të paraqitura për auditim kishin një numër lëshimesh dhe pasaktësish. Disa janë ndryshuar në versionin final të Pasqyrave Vjetore Financiare, por menaxhmenti zgjodhi t'i linte disa zëra të pakorrigjuara. Rreziqet domethënëse në Pasqyrat Vjetore Financiare ishin regjistrimi i gabuar i pasurive. Mbi 5.2 milionë të investimeve në vijim (të pa përfunduara) ishin regjistruar si pasuri;
- Rreziqet tjera që ishin materializuar ishin: Raportimi i gabuar i pagesave nga palët e treta në shumën prej 207,544€, pagesa këto të kryera nga ministritë e linjës. Komuna kishte bërë edhe regjistrim të gabuar të pagesave në kode ekonomike në një shumë të konsiderueshme (486,383€). Kjo shumë e destinuar për investime kapitale ishte

paguar për mallra dhe shërbime dhe subvencione. Po ashtu, shuma e llogarive të arkëtueshme ishte keq pohuar për 130,000€;

- Rekomandimet e vitit 2012 dhe të viteve të mëparshme nuk janë implementuar ende. Kjo do të rezultojë në kontrole të dobëta/vlerë të dobët për para/humbje potenciale financiare të vazhdueshme;
- Trendi jonormal i inkasimit të të hyrave ngrit nevojën e një planifikimi shumë më të mirë të burimeve vetjake financiare. Të hyrat e mbledhura në vitin 2013 ishin 100% më të vogla sesa ato në vitin 2012, por 138% më të mëdha se në vitin 2011. Kjo kishte implikime edhe në ekzekutimin e dobët të buxhetit për investime kapitale (87%). Duket se komuna nuk ka konsistencë në planifikim dhe si rezultat i kësaj, planifikimi i të hyrave nga tatimi në pronë ishte për 14% më i ulët se faturimet;
- Edhe pse ne arritëm të merrnim siguri nga kontrollet efektive të menaxhmentit në disa fusha të pasqyrave, vlerësimi ynë për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin ka nxjerr në pah se në disa fusha të rëndësishme të veprimtarisë ekzistojnë dobësi domethënëse. Kjo veçanërisht ka ndodhur në menaxhimin e pronave publike, ku në rreth 20 raste, kontraktorët kanë vazhduar të shfrytëzojnë pronat publike edhe pas skadimit të kontratave;
- Kontrole të dobëta janë identifikuar edhe në fushën e prokurimeve, siç është dhënia e kontratave operatorëve të pa përgjegjshëm, mangësitë në zbatimin e procedurave dhe çertifikimi i pagesave para se të jenë bërë raportet e pranimit; dhe
- Menaxhmenti, gjithashtu, nuk kishte kontrole efektive mbi inventarizimin e pasurive, dhe si shkak i vonësive të komisioneve në dorëzimin e raporteve, rezultatet e regjistrimeve nuk ishin proceduar në regjistra të pasurive dhe nuk ishte bërë barazimi i gjendjeve.

#### **Ne rekomandojmë Kryetarin të:**

- Sigurojë që në procesin e hartimit të Pasqyrave Vjetore Financiare për vitin 2014 të përfshihet formalisht edhe rishikimi nga menaxhmenti i draft pasqyrave, me fokus të veçantë në fushat që konsiderohen me rrezik të lartë për gabime dhe/ose fushat ku gabimet janë identifikuar në vitet e mëparshme. Stafi përgjegjës për përgatitjen e Pasqyrave Vjetore Financiare duhet të ketë kompetencën e duhur profesionale, ose të ndjekë trajnime shtesë në këtë fushë;
- Sigurojë që plani i veprimit, i rishikuar, të përcaktojë saktë afatet kohore për adresimin e rekomandimeve të bëra nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm, me stafin përgjegjës të identifikuar, duke u fokusuar fillimisht në fushat më të rëndësishme;
- Me rastin e planifikimit të të hyrave vetjake të shqyrtoj të gjitha informatat relevante dhe objektive, duke marrë parasysh edhe trendin e të hyrave në vitet e kaluara, duke qenë se dështimet në planin e të hyrave kanë implikime buxhetore dhe efekte në realizimin e projekteve nga këto burime;

- Shqyrtoj të gjitha kontratat për dhënie e pronave publike në shfrytëzim me qira, veçanërisht në aspektin e vlefshmërisë së kontratave dhe të ndërmerr veprimet e duhura;
- Kryejë një vlerësim të detajuar të procesit të Prokurimit dhe kontrollit për të kuptuar se pse dobësitë vazhdojnë të shfaqen dhe të identifikojë veprimet që duhen zbatuar për t'i adresuar këto dobësi;
- Siguroj se komisionet për vlerësimin dhe inventarizimin e pasurive themelohen me kohë dhe raportet e komisionit përgatiten para se Pasqyrat Vjetore Financiare t'i dorëzohen Qeverisë, dhe rezultatet e raporteve të krahasohen/azhurnohen me regjistrat e pasurive; dhe
- Siguroj që komiteti i auditimit të brendshëm të funksionalizohet dhe të ndihmoj realizimin sa më efektiv të funksionit të auditimit të brendshëm.

### **Përgjigja e Menaxhmentit - auditimi për vitin 2013**

Menaxhmenti është pajtuar me të gjitha të gjeturat e auditimit dhe është zotuar se do t'i adresoj rekomandimet tona.

## 1 Fushëveprimi i auditimit dhe metodologjia

Është përgjegjësi e Kryetarit të Komunës dhe Zyrtarit Kryesor Financiar (ZKF) të përgatis Pasqyrat Vjetore Financiare (PVF) sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik (SNKSP) për “Raportimin Financiar në bazë të Kontabilitetit të Parasë së Gatshme” dhe kërkesave të tjera specifike. Zyra e Auditorit të Përgjithshëm (ZAP) është përgjegjëse për kryerjen e auditimit të rregullsisë që përfshin ekzaminimin dhe vlerësimin e pasqyrave financiare dhe të dhënave tjera financiare si dhe dhënien e opinionëve:

- Nëse PVF japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Për përshtatshmërinë e funksioneve të kontrollit të brendshëm dhe të auditimit të brendshëm; dhe
- Për të gjitha çështjet të cilat dalin apo kanë të bëjnë me auditimin.

Ne kemi shqyrtuar shkallën deri në të cilën mund të mbështetemi në kontrollet menaxheriale gjatë përcaktimit të testimit të hollësishëm, të cilat janë të nevojshme për të siguruar nivelin e nevojshëm të dëshmive për të mbështetur opinionin e Auditorit të Përgjithshëm dhe fokusin e auditimit tonë të pajtueshmërisë.

Pjesët e mëposhtme ofrojnë një përmbledhje më të detajuar të të gjeturave tona të auditimit me theks të veçantë në vëzhgimet dhe rekomandimet në çdo fushë të rishikimit. Për të qenë më i plotë, ne kemi përfshirë çështjet e identifikuar gjatë auditimit të ndërmjetëm aty ku ato kanë mbetur relevante. Të gjeturat tona janë definuar si:

**Të prioritetit të lartë** – Çështje të cilat mund të rezultojnë në dobësi materiale në kontrollin e brendshëm dhe ku veprimi i marrë do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme; dhe

**Të prioritetit të mesëm** - Çështje të cilat mund të mos rezultojnë në dobësi materiale, por ku veprimi i marrë do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme.

Procedurat tona kanë përfshirë një rishikim të kontrolleve të brendshme dhe sistemeve të kontabilitetit dhe procedurat vetëm deri në atë masë që konsiderohet e nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen sikur përfaqësojnë një pasqyrë gjithëpërfshirëse të të gjitha dobësive të cilat ekzistojnë, apo edhe të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë funksionuar. Të gjeturat që konsiderohen si me prioritet të ulët do të raportohen veçmas stafit të financave.



## 2 Pasqyrat vjetore financiare dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm

### Konkluzioni i përgjithshëm

Rishikimi ynë i PVF merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë dhe saktësinë e informacionit të regjistruar në pasqyrat financiare. Ne gjithashtu e marrim parasysh deklaratën e bërë nga Kryetari dhe ZKF, kur draft PVF-të të dorëzohen në Qeveri.

Deklarata në lidhje me prezantimin e PVF përfshin një numër të pohimeve për sa i përket pajtueshmërisë me kornizën raportuese dhe cilësinë e informacionit në kuadër të pasqyrave financiare. Disa deklarata kanë për qëllim t'i ofrojnë Qeverisë sigurinë se të gjitha informatat relevante janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një auditim gjithëpërfshirës.

### 2.1 Opinioni i Auditimit

#### *Opinion i Pamodifikuar<sup>1</sup> me theksim të çështjes*

Sipas opinionit tonë Pasqyrat Vjetore Financiare prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë, në të gjitha aspektet materiale.

Si *Theksim i çështjes* Regjistri i Pasurive Fikse ende nuk është i besueshëm dhe i saktë për arsye se 5,147,283€, projekte të kontraktuara nga niveli qendror ishin regjistruar nga komuna vetëm në bazë të njoftimit për dhënie të kontratës pa pasur informacione për përfundimin e projekteve. Po ashtu komuna kishte bërë keq klasifikim të shpenzimeve ku nga kategoria e investimeve kapitale kishte paguar për mallra dhe shërbime vlerën prej 291,297€ dhe për subvencione vlerën prej 195,086€. Llogaritë e arkëtueshme ishin të mbivlerësuara për 131,000€. Regjistri i pasurive fikse, llogarive të arkëtueshme dhe keq klasifikimi ekonomik i shpenzimeve nuk ka ndikim në ndonjërin prej dy Pasqyrave Vjetore Financiare ('Pranimet dhe Pagesat në Para të Gatshme' dhe 'Krahasimi i Buxhetit me Shumat Aktuale') në pajtim me SNKSP në bazë të kontabilitetit të parasë së gatshme.

**(SNISA 200 Opinion i Pamodifikuar me theksim të çështjes)**

<sup>1</sup> Termi „opinion i pamodifikuar“ është ekuivalent me termin „opinion i pakualifikuar“ i përdorur në versionin paraprak të Raportit Vjetor. Terminologjia e re është në pajtim me standardet të reja të INTOSAI-t (SNISA 200). Për më tutje referohu në shtojcën I.

## 2.2 Rreziqet domethënëse në Pasqyrat Vjetore Financiare

### Përshkrimi

Në Memon tonë të planifikimit të auditimit, të datës 11.11.2013, është identifikuar rreziku domethënës në PVF lidhur me plotësinë e pasurive, ndërsa rreziqet që ne nuk i kishim identifikuar në memon e planifikimit por që kanë ndodhur ishin: pagesat nga palët e treta, keq klasifikimi i shpenzimeve dhe mos prezantimi i plotë i llogarive të arkëtueshme.

Këto janë rreziqe të anomalive materiale, nga të cilat mund të rezultojë një opinion i modifikuar, përfshirë Theksimin e Çështjes.

Rreziqet e anomalive materiale që ne kemi identifikuar në lidhje me plotësinë e pasurive dhe keq-klasifikimin kanë ndodhur për shkak se menaxhmenti nuk kishte ndërmarrë veprime për të adresuar rreziqet e paraqitura.

### Rreziku i identifikuar

**Çështja 1 -Pagesat nga palët e treta në PVF nuk ishin prezantuar në shuma të sakta - Prioritet i lartë**

#### E gjetura

Vlera 526,277€ e prezantuar në PVF të shtylla e pagesave nga palët e treta nuk ishte e saktë për shkak se në këtë vlerë ishin të prezantuar edhe financimet e bëra nga ministria e linjës në vlerë prej 84,073€.

**Rekomandimi 1 Prioritet i lartë** - Kryetari duhet të analizoj arsyet për keq deklarimet lidhur me pagesat nga palët e treta dhe të siguroj se pagesat nga palët e treta të raportohen në mënyrë të plotë dhe të saktë në PVF-të.

### Rreziku i identifikuar

**Çështja 2 - Pasuritë e komunës nuk ishin regjistruar në mënyrën e plotë dhe të saktë në PVF - Prioritet i lartë**

#### E gjetura

Ne kemi vlerësuar kontrollet e zbatuara nga menaxhmenti për ta dëshmuar plotësinë e të dhënave të pasurive në kontekst të shpenzimeve kapitale për vitin 2013 dhe vitet paraprake. Në memon e auditimit të ndërmjetëm, ne i kemi dhënë këshilla menaxhmentit për veprimin që nevojitet për të siguruar që shifra e pasurive në PVF të ishte e saktë. Megjithatë, rreziku i identifikuar është materializuar sepse Menaxhmenti nuk ka arritur të aplikojë sa duhet përmirësimet e nevojshme në kontrollin e brendshëm dhe ne kemi konfirmuar që vlerat e

pasurive të regjistruara në PVF në shumë prej 279,277,297€ janë materialisht të pasakta. Në këtë vlerë ishin përfshirë 5,147,283€ si pasuri që ishin regjistruar vetëm në bazë të njoftimit për dhënie të kontratës pa pasur informacione për përfundimin e projekteve. Sipas rregullës për pasuri projektet të cilat janë në ndërtim duhet të regjistrohen si investime në vijim dhe nuk llogaritet zhvlerësimi. Pas përfundimit të projekteve, ato regjistrohen si pasuri në përdorim dhe fillon të llogaritet zhvlerësimi.

**Rekomandimi 2 Prioritet i lartë-** Kryetari duhet të identifikojë arsyet për keq deklarimin fillestar të pasurive dhe dështimin për ndjekur këshillat e ZAP. Procesi të duhura duhet të vendosen në vitin 2014 për të siguruar se asnjë projekt kapital i pa përfunduar, nuk do të regjistrohet si pasuri para se i njëjti t'i dorëzohet komunës.

### Rreziku i identifikuar

#### Çështja 3 - Keq klasifikimi i shpenzimeve në kode ekonomike - Prioritet i lartë

#### E gjetura

Me rastin e pagesave, Komuna kishte bërë keq klasifikim të shpenzimeve sipas kodeve ekonomike, duke paguar 486,383€ nga kategoria investime kapitale për blerjen e mallrave dhe shërbimeve (291,297€) dhe për subvencione (195,086€).

**Rekomandimi 3 Prioritet i lartë -** Kryetari i Komunës duhet të sigurojë vendosjen e një sistemi të kontrollit në klasifikimin e pagesave në kode ekonomike adekuate, sipas buxhetit të aprovuar në bazë të kategorive dhe të planit kontabël.

## 2.3 Pajtueshmëria me kërkesat për raportim në PVF

### Përshkrimi

PVF duhet të jenë në përputhje me kornizën e caktuar raportuese. Ne kemi marrë parasysh:

- Pajtueshmërinë me RrF nr. 03/2013;
- Kërkesat e LMFP-së nr. 03/L-048;
- PVF janë përgatitur brenda kornizës kohore dhe janë dorëzuar në Ministrinë e Financave;
- PVF janë nënshkruar nga Kryetari i Komunës dhe ZKF;
- PVF janë pranuar në gjuhën shqipe dhe serbe;
- PVF janë përgatitur në kopje fizike dhe elektronike; dhe

- Komuna kishte përgatitur dhe dorëzuar raporte të rregullta tremujore tek Kuvendi Komunal dhe një kopje tek Ministri i MF gjatë vitit 2013.

Nuk kemi asnjë çështje për të ngritur në lidhje me plotësimin e kërkesave të mësipërme.

Megjithatë, PVF fillestare kanë përmbajtur disa gabime. Gjatë auditimit ne i kemi dhënë mundësin komunës që të korrigjohen ato, mirëpo komuna nuk i bëri korrigjimet e duhura. Më poshtë paraqesim mangësitë e tyre:

---

#### **Çështja 4 - Procesi i përgatitjes së Pasqyrave Vjetore Financiare - Prioritet i Lartë**

**E gjetura** Pagesat nga palët e treta të prezantuara në PVF nuk ishin të plota për faktin se komuna kishte paraqitur si pagesë nga palët e treta edhe pjesën e financiar nga institucionet e nivelit qendror (Ministritë). Shuma e prezantuar gabimisht ishte 84,073€.

Në shënimin 30 përmbledhja e pasurive jo financiare- Komuna i kishte mbivlerësuar pasuritë për 5,147,283€. Për më shumë referoju kapitullit 2.2 të këtij raporti ku tregon gjendjen e pasurive.

Komuna kishte bërë keq klasifikim të shpenzimeve duke paguar 486,383€ nga kategoria investime kapitale për mallra dhe shërbime dhe subvencione.

Në shënimin 34 llogaritë e arkëtueshme, Komuna kishte prezantuar llogari të arkëtueshme për tatimin në pronë në shumë prej 1,896,000€ derisa ishte dashur të jenë 1,765,000€, me një diferencë prej 131,000€.

**Rreziku** Paraqitja jo e saktë e PVF dhe gabimet e identifikuar në shumat e regjistruara shpie në një keqkuptim të pozitës financiare të komunës dhe ka ndikim potencial negativ në saktësinë e kërkesave të ardhshme buxhetore.

**Rekomandimi 4** Kryetari duhet të sigurojë që plani i prodhimit të llogarive për vitin 2014 formalisht adreson të gjitha kërkesat për pajtueshmëri lidhur me PVF-të, me fokus të veçantë në fushat e theksuara më lartë. Deklarata e bërë nga Kryetari dhe ZKF lidhur me saktësinë e PVF-ve nuk duhet të dorëzohet pa u siguruar se janë zbatuar të gjitha kontrollet relevante për PVF-të .

## 2.4 Pajtueshmëria me kërkesat e tjera për raportim të jashtëm

### Përshkrim

Përveç hartimit të PVF-ve, nga Kryetari kërkohet të adresojë obligimet për raportim të jashtëm si në vijim:

- Kërkesa Buxhetore për financim të projekteve kapitale në MF;
- Raportet tremujore, duke përfshirë pasqyrat financiare nëntë mujore me kohë;
- Raportet operative (të performancës);
- Draft plani i prokurimit me kohë;
- Raportet mbi borxhet të dorëzuara në MF; dhe
- Plani i Veprimit për implementimin e rekomandimeve.

Ne nuk kemi çështje për të ngritur në lidhje me këto, pasi që komuna i ka përmbushur të gjitha obligimet për raportim të jashtëm. Po ashtu, plotësimi i kërkesave ka qenë i cilësisë së mirë dhe në pajtim me afatet kohore që janë kërkuar.

### Rekomandimet

Ne nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

### 3 Rekomandimet e vitit paraprak

#### Konkluzioni i përgjithshëm

Menaxhmenti i komunës nuk i kishte kushtuar vëmendjen e duhur zbatimit të rekomandimeve të dhëna në vitin e kaluar dhe kjo ka shkaktuar që gjysma e rekomandimeve të përsëriten edhe në këtë vit.

#### Përshkrimi

Raporti ynë i auditimit për PVF-ve të vitit 2012 kishte rezultuar me 13 rekomandime. Komuna kishte përgatitur dhe dorëzuar një plan për adresimin e rekomandimeve nga viti paraprak. Sidoqoftë, ende kërkohet implementimi i shumicës së rekomandimeve.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2013, pesë rekomandime janë adresuar plotësisht; dy janë adresuar pjesërisht, dhe gjashtë nuk janë adresuar ende. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrës se si janë adresuar ato, shihni Shtojcën II.

---

#### Çështja 5 - Adresimi i dobët i rekomandimeve nga viti paraprak - Prioritet i lartë

**E gjetura** Vetëm një pjesë e rekomandimeve të vitit të kaluar janë adresuar sepse Komuna nuk ka zbatuar ndonjë proces formal për të menaxhuar dhe monitoruar mënyrën e adresimit të rekomandimeve të ZAP. Dobësitë e vazhdueshme të kontroleve të brendshme në sistemet financiare kyçe kanë treguar që: shkalla e dobët e inkasimit të të hyrave nuk është trajtuar, pagesat nga kategoritë jo adekuate ekonomike, regjistri i aseteve mbetet i pakompletuar si dhe procesi i përgatitjes së PVF është i dobët.

**Rreziku** Dështimi në implementimin e rekomandimeve të AP do të rezultojë në humbje financiare të komunës dhe jo efektivitet të vazhdueshëm, i cili rezulton në dhënie të shërbimeve jo cilësore dhe pasaktësitë në PVF dhe regjistrat financiar përkatës.

**Rekomandimi 5** Kryetari duhet të siguroj se një plan i rishikuar, praktik njëkohësisht edhe sfidues, është hartuar për të adresuar rekomandimet e bëra nga Auditori Përgjithshëm, duke caktuar stafin përgjegjës me një fokus fillestar në fushat më të rëndësishme. Zbatimi i këtij plani duhet të rishikohet nga kryetari në baza mujore.

## 4 Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli

### 4.1 Konkluzioni i përgjithshëm

Qasja jonë e auditimit është fokusuar në të kuptuarit dhe vlerësimin e veprimeve të ndërmarra nga menaxhmenti për të siguruar menaxhim financiar dhe kontroll efektiv dhe rezultate nga këto veprime. Për sisteme individuale financiare, ne kërkojmë të identifikojmë nivelin në të cilin operojnë kontrollet aktuale. Ne konsiderojmë se kontrollet janë të dizajnuara mirë, por nuk ishin aq sa duhet funksionale. Kjo kërkon një vlerësim të strukturave, proceseve dhe linjave të llogaridhënies të prezantuara nga menaxhmenti, duke përfshirë rolin e ndërmarrë nga Auditimi i Brendshëm dhe Komitetet e Auditimit.

Ne kemi gjetur se kontrollet mbi procesin e planifikimit të të hyrave nuk janë të mira dhe nuk janë analizuar në mënyrë të qëndrueshme, kontrollet mbi një sërë fushash të shpenzimeve kërkojnë përmirësim të mëtejshëm në mënyrë që të parandalojë që komuna të ketë humbje financiare, vlerë të dobët për paranë dhe menaxhim jo efektiv të projekteve. Fushat kryesore ku nevojiten më shumë përmirësime janë, planifikimi i të hyrave, procesi i prokurimit, monitorimi i subvencioneve, regjistrimi i pasurisë, raportimi i saktë i obligimeve në PVF-të dhe funksionalizimi i komitetit të auditimit të brendshëm.

## 4.2 Qeverisja e mirë

Raportimi financiar i brendshëm në kuadër të komunës është i rregulluar me kornizën ligjore në fuqi. Sidoqoftë, dobësitë në kontrollet e nivelit të lartë të identifikuara nga NjAB dhe Auditori i Përgjithshëm sugjerojnë se menaxhmenti do duhej të ndërmerret një qasje aktive të adresimit të këtyre çështjeve.

---

### Çështja 6- Dobësi në kontrollet e menaxhmentit të lartë – Prioritet i lartë

- E gjetura**                      Auditimi i vitit 2013 ka identifikuar dobësi në kontrolle në të gjitha kategoritë ekonomike, veçanërisht në periudhën e fund vitit. Këto dobësi nuk ishin identifikuar në mënyrë efektive përmes mbikëqyrjes së brendshme dhe raportuar tek menaxhmenti apo ku ato ishin identifikuar, nuk ishin marrë veprimet e duhura.
- Rreziku**                              Dobësitë në funksionimin e kontrolleve menaxheriale në sistemin financiar dhe koncentrimi i shpenzimeve në fund vit, reduktojnë aftësitë e menaxhmentit për të menaxhuar në mënyrë aktive aktivitetet e komunës dhe redukton kontrollin efektiv buxhetor.
- Rekomandimi 6**                      Kryetari duhet të sigurojë se një strukturë e përshtatshme qeverisëse është zbatuar përmes së cilës menaxhmenti i lartë është i informuar për mangësitë e kontrollit dhe në mënyrë aktive i menaxhon ato.



## 4.3 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

### Përshkrimi

Në kemi shqyrtuar burimin e fondeve buxhetore për komunën, shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike dhe të hyrat e inkasuara. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

**Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore – shpenzimi ndaj buxhetit (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final <sup>2</sup>	2013 Shpenzimi	2012 Shpenzimi	2011 Shpenzimi
<b>Burimet e Fondeve:</b>	<b>12,281,590</b>	<b>13,648,500</b>	<b>12,719,099</b>	<b>12,155,556</b>	<b>11,655,181</b>
Granti i Qeverisë -Buxheti	10,498,590	10,498,590	10,286,473	9,969,500	9,849,710
Të bartura nga viti paraprak <sup>3</sup>	-	1,364,123	1,215,673	547,088	1,154,675
Të hyrat vetanake <sup>4</sup>	1,783,000	1,783,000	1,216,459	1,609,666	608,781
Donacionet e brendshme	-	465	-	5,000	10,534
Donacionet e jashtme	-	2,322	494	24,302	31,481

Buxheti final krahasuar me buxhetin fillestar është më i lartë për 1,366,910€. Kjo rritje është rezultat i të hyrave të bartura nga viti paraprak për 1,364,123€ dhe donacioneve të brendshme në shumë prej 465€ dhe donacioneve të jashtme në shumë prej 2,322€.

Në vitin 2013, komuna ka përdorur 93% të buxhetit final ose 12,719,099€. Në përqindje, nivel i njëjtë i shpenzimeve ishte edhe në vitin 2012.

<sup>2</sup> Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi që është e përshtatur vazhdimisht nga Ministria e Financave

<sup>3</sup> Të hyrat vetanake të Komunave të pashpenzuara në vitin paraprak të bartura në vitin aktual.

<sup>4</sup> Të hyrat komunale të planifikuara dhe të mbledhura në vitin aktual që është përdorur nga entiteti për financimin e buxhetit të vet.

**Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike- shpenzimi ndaj buxhetit (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2013 Shpenzimi	2012 Shpenzimi	2011 Shpenzimi
<b>Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:</b>	<b>12,281,590</b>	<b>13,648,500</b>	<b>12,719,099</b>	<b>12,155,556</b>	<b>11,655,181</b>
Pagat dhe Mëditjet	6,100,000	6,158,504	6,052,770	6,041,205	5,811,928
Mallrat dhe Shërbimet	821,468	897,313	888,926	986,698	858,319
Shërbimet komunale	237,000	237,000	232,194	226,891	201,178
Subvencionet dhe Transferet	163,000	206,947	204,581	126,775	128,565
Investimet Kapitale	4,960,122	6,148,736	5,340,628	4,773,987	4,655,191

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore janë në dhënë si në vijim:

- Pavarësisht rritjes në buxhetin për shpenzime kapitale, 87% e buxhetit ishte shpenzuar. Arsyeja për këtë ishte se komuna ka planifikuar që prej të hyrave vetanake të investoj në kategorinë e kapitaleve, mirëpo nuk e ka realizuar planin e paraparë për të hyrat.
- Rritja e buxhetit për Paga dhe Mëditje me 58,504€ dhe Mallra dhe Shërbime për 75,845€ kishte rezultuar prej të hyrave të bartura nga viti i mëparshëm.

Asnjë vit të hyra vetjake nuk shpenzohen në tërësi, si rezultat direkt i mos ekzekutimit të buxhetit, duke patur parasysh se të hyrat vetjake janë burimi i fundit financiar i përdorur. Në vitin 2014 vlera e bartur e të hyrave ka qenë 385 mijë euro.

**Tabela 3. Të hyrat vetjake komunale të buxhetuara dhe të mbledhura në vitin 2013 (në euro)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2013 Pranimet	2012 Pranimet	2011 Pranimet
Të hyrat vetanake	1,783,000	1,783,000	1,453,778	2,906,049	608,781

Duke iu referuar tabelës më lart, shihet se komuna nuk ka konsistencë në planifikimin dhe realizimin e të hyrave.

Buxheti fillestar për të hyrat vetjake nuk pasqyronte pranimet e vitit të kaluar dhe faktorët e tjerë relevant. Nga tabela shihet se realizimi i të hyrave ishte 82%.

Në anën tjetër, listat e debitorëve ndaj komunës kanë kaluar shifrën prej 3.7 milionë euro, që paraqet një shumë domethënëse për komunën dhe gjendja e llogarive të arkëtueshme është në rritje të vazhdueshme.

---

#### **Çështja 7 Ekzekutimi i buxhetit – Prioriteti i Lartë**

**E gjetura** Ekzekutimi i buxhetit në nivel të përgjithshëm ishte në nivelin e pritur, përveç te kategoria e investimeve kapitale. Pjesa e buxhetit të pa shpenzuar prej 13% për projektet kapitale ishte për arsye të mos inkasimit të hyrave vetjake dhe mbylljes së afatit të zotimeve si rezultat i vonesave në alokimin e të hyrat vetanake.

**Rreziku** Ekziston një mospërputhje e lartë në mes planit dhe shpenzimeve. Planifikimi jo i duhur i buxhetit dhe ekzekutimi i ulët mund të rezultojë në mos arritjen e objektivave të organizatës dhe financimin e detyrimeve të vitit aktual nga buxhetet e vitit të ardhshëm

**Rekomandimi 7** Kryetari duhet të sigurojë se procesit të përgatitjes së buxhetit i paraprinë një rivlerësim rigoroz i procesit i cili pasqyron në mënyrë të plotë të gjitha informatat relevante, përfshirë lëvizjet e viteve të kaluara apo ndryshimet e pritura nëpër vite.

## **4.4 Të hyrat vetanake**

### **Përshkrimi**

Të hyrat e gjeneruara ishin 1,453,778€. Këto kanë pasur të bëjnë me të hyrat nga tatimi në pronë, lejet e ndërtimit, të hyrat nga qiraja etj.

---

#### **Çështja 8 – Planifikim jo i mirë i të hyrave nga tatimi në pronë – Prioritet i mesëm**

**E gjetura** Komuna kishte planifikuar të inkasoi të hyra nga tatimi në pronë në shumë prej 600,000€ derisa kishte inkasuar 556,123€.

**Rreziku** Planifikimi jo i mirë redukton mundësinë e vendimmarrjes së menaxhmentit për të planifikuar financimin e projekteve nga burimet vetjake.

**Rekomandimi 8** Kryetari duhet të sigurojë që krahas përmirësimit të planifikimit, duhet të siguroj se mekanizmat adekuat për mbledhjen e tatimit në pronë, janë në veprim dhe sigurojnë shkallën maksimale të inkasimeve.

---

### **Çështja 9 - Dhënia e lejeve të ndërtimit në kundërshtim me kërkesat ligjore -Prioritet i mesëm**

**E gjetura** Gjatë auditimit të lejeve të ndërtimit identifikua se në një rast komuna kishte dhënë lejen e ndërtimit në mungesë të dëshmisë për pagesën e taksës në vlerë 42,453€. Komuna kishte nënshkruar një marrëveshje me investitorin për pagesën e taksës në 15 këste. Ligji për ndërtim neni 21 kërkon se pas ofrimit të dëshmisë për pagesën e taksës për leje ndërtimi nga aplikuesi, organi kompetent brenda një afati optimal i jep lejen e ndërtimit.

**Rreziku** Dhënia e lejeve të ndërtimit pa kryer obligimin financiar ndaj komunës përveç që është në kundërshtim me ligjin e ndërtimit , ajo paraqet rrezik që mjetet të mos inkasohen nga komuna dhe zvogëlon në mënyrë direkte të hyrat vetjake.

**Rekomandimi 9** Kryetari duhet të siguroj që dhënia e lejeve të ndërtimit të shqyrtohet si dhe të siguroj se të gjitha kërkesat që pasojnë në të ardhmen, të trajtohen në pajtim me kërkesat ligjore për dhënien e lejeve të ndërtimit.

### **Çështja 10 - Mos azhurnim i kontratave për shfrytëzim të objekteve dhe pronës publike - Prioritet i lartë**

**E gjetura** Testimi ynë i të hyrave nga shfrytëzimi i pronës publike ka identifikuar që kontratat për shfrytëzim të pronave dhe objekteve publike ishin me afat të skaduar. 20 kontrata ishin valide deri më 31.12.2012 derisa për vitin 2013 komuna kishte faturuar edhe bizneset të cilët nuk kishin kontratat valide.

**Rreziku** Mos ndërmarrja e masave nga ana e Komunës lidhur me azhurnimin e kontratave për shfrytëzim të pronës komunale rritë rrezikun që shfrytëzuesit e këtyre lokaleve të mos kryejnë obligimet financiare ndaj komunës dhe ndikon në zvogëlimin e të hyrave vetanake.

**Rekomandimi 10** Kryetari i komunës duhet të rishqyrtoj në Asamblenë komunale çështjen e kontratave të skaduara, dhe aty ku e vlerëson të arsyeshme, të vazhdoj kohëzgjatjen e kontratave. Në të kundërtën, të ndaloj shfrytëzimin e pronave publike për shfrytëzuesit që nuk posedojnë kontratat valide.

## 4.5 Shpenzimet

### 4.5.1 Prokurimi

#### **Përshkrimi**

Gjatë vitit 2013 përmes prokurimit në investime kapitale dhe mallra dhe shërbime ishin shpenzuar 6,461,747€. Ne kemi testuar 22 lëndë të prokurimit në vlerë 1,983,553€ dhe 43 pagesa në vlerë prej 888,793€.

Auditimi jonë ka identifikuar disa dobësi në procesin e prokurimit mbi të cilat kontrollet nuk ishin zbatuar në mënyrë efektive.

Ne nuk kemi mundur të vlerësojmë progresin e projekteve për investime kapitale ngase zyrtarët komunal nuk kanë arritur të na sigurojnë dëshmi për nivelin e ekzekutimit të projekteve kapitale në aspektin fizik dhe as progresin financiar.

---

#### **Çështja 11 - Dhënie e kontratave OE të pa përgjegjshëm - Prioritet i mesëm**

**E gjetura** Në dy raste kemi vërejtur se komuna kishte zhvilluar procedurat e prokurimit në mungesë të operatorëve të përgjegjshëm. Rastet e identifikuarra ishin:

a) Tek “Ndërtimi i rrugës Grejkoc faza II” në shumë prej 9,970€. Prej 3 ofertave, vetëm 2 ishin të përgjegjshme sepse njëri ofertues kishte borxhe ndaj ATK-së, që ishte në kundërshtim me kriterin e vendosur; dhe

b) Tek “Mirëmbajtja e objekteve institucionale - Sigurimi fizik i kampit Kasablanka” me vlerë të parashikuar 38,000€, nga 2 ofertues që kishin dorëzuar ofertë, vetëm fituesi ishte i përgjegjshëm.

**Rreziku** Zhvillimi i procedurave në mungesë të numrit minimal të operatorëve të përgjegjshëm nuk është në pajtim me kërkesat e LPP, dhe si i tillë dëmton konkurrencën dhe transparencën e procesit.

**Rekomandimi 11** Kryetari duhet të siguroj se shërbimi i prokurimit do të shqyrtoj me kujdes dhe kompetencë proceset e prokurimit dhe të siguroj se veprimet e ndërmarra janë në pajtim të plotë me rregullat e prokurimit. Në rastet kur kushtet nuk janë plotësuar, aktivitetet e prokurimit duhet të anulohen.

## Çështja 12 - Mangësi në zbatimin e procedurave - Prioritet i mesëm

**E gjetura** Në katër (4) procedura të hapura të prokurimit nuk ishte respektuar neni 71 i LPP-së i cili parasheh që pjesëmarrësit në grup duhet të ofrojnë një deklaratë të nënshkruar nga secili prej anëtarëve që konfirmojnë pjesëmarrjen në grup dhe nuk marrin pjesë në ndonjë grup tjetër ose individualisht në të njëjtën procedurë të prokurimit. Ne kemi vërejtur se kjo nuk ishte bërë nga pjesëmarrësit, tek kontratat:

a) Ndërtimi i aneksit të bibliotekës në vlerë prej 395, 802€;

b) Ndërtimi i sistemit të ujitjes në vlerë prej 29,216€;

c) Ndërtimi i QMF-së në Suharekë në vlerë prej 36,470€; dhe

d) Ndërtimi i planit rregullativ në Samadraxhë në vlerë prej 13,965€.

**Rreziku** Mungesa e deklaratave të nënshkruara nga ofertuesit rrit rrezikun që të njëjtit pjesëmarrës të marrin pjesë më shumë se një herë në të njëjtat aktivitete të prokurimit, duke e dëmtuar parimin e konkurrencës.

**Rekomandimi 12** Kryetari të siguroj që stafi vlerësues është i pajisur me njohuritë e nevojshme për të vlerësuar proceset e prokurimit dhe që sipas nevojës të organizohen trajnime për t'i mbajtur të përditësuar me kërkesat dhe ndryshimet e Legjislacionit.

## Çështja 13 - Çertifikim i pagesës para dorëzimit të raportit mbikëqyrës - Prioritet i lartë

**E gjetura** Për mirëmbajtjen dhe pastrimin e qytetit, komuna kishte bërë një pagesë në shumë prej 19,989€ para se të verifikohet nga organi mbikëqyrës. Çertifikim i pagesës ishte bërë me datën 15.02.2013, ndërsa organi mbikëqyrës kishte dorëzuar raportin e mbikëqyrjes me datën 24.02.2013.

**Rreziku** Kontrollat e çertifikimit funksionojnë dobët dhe nuk sigurojnë se kërkesat ligjore po zbatohen. Ekzekutimi i pagesave në mungesë të dëshmive se punët apo shërbimet e kontraktuara janë kryer, rrit rrezikun që ato të mos kryhen fare, apo të mos jenë të kualitetit të pritur.

**Rekomandimi 13** Kryetari duhet të siguroj që janë vendosur kontrolle shtesë me rastin e çertifikimit të pagesave. Zyrtari çertifikues duhet të bëjë çertifikimin e pagesave vetëm pasi të jenë përmbushë të gjitha kushtet e përcaktuara me ligj, respektivisht pasi malli të jetë pranuar, dhe punët ose shërbimet të jenë kryer në pajtim me kontratat.

#### **Çështja 14 - Mungesë e nënshkrimit të dokumenteve standarde në procesin e prokurimit - Prioritet i mesëm**

**E gjetura** Në katër rastet raporti i vlerësimit të tenderëve nuk ishte i nënshkruar nga disa anëtarë, në dy rastet procesverbali hapjes nuk ishte i nënshkruar nga disa anëtar dhe në një rast deklarata në betim nga një anëtarë i komisionit vlerësues nuk ishte i nënshkruar.

**Rreziku** Mungesa e nënshkrimeve të dokumenteve standarde paraqet rrezik që anëtarët të mos kenë qenë pjesëmarrës në proceset e prokurimit dhe që të njëjtit të mos mbahen përgjegjës dhe llogaridhënës për punën e tyre.

**Rekomandimi 14** Kryetari duhet të siguroj një monitorim më efektiv të procesit të prokurimit përmes menaxherit të prokurimit, në mënyrë që rastet e tilla të mos përsëriten.

### **4.5.2 Kompensimet (pagat dhe mëditjet)**

#### **Përshkrimi**

Buxheti i planifikuar për kategorinë e pagave dhe mëditjeve ishte 6,158,504€, ndërsa shpenzimet për këtë kategori ishin 6,052,770€ apo rreth 98%.

Pagat dhe Mëditjet paguhen përmes një sistemi të centralizuar (payrollit). Kontrollat që operojnë në nivel lokal nga komuna kanë të bëjnë me a) kontrollin e pagesave çdo muaj duke i nënshkruar listën e pagave b) verifikimin e ndryshimeve të mundshme që mund të paraqiten përmes formularëve, c) rishikimin e buxhetit për këtë kategori dhe barazimet me thesarin.

Për këtë kategori testuam 42 mostra ku rishikuam pajtueshmërinë e listave të pagave me sistemin e payrollit në Ministria e Administratës Publike (MAP). Po ashtu, kemi shikuar nëse pozitat e zyrtarëve dhe koeficientët janë në pajtueshmëri me formën e sistemit të payrollit dhe listës së pagave dhe konstatuam se çështjet e cekura janë në pajtim me kërkesat ligjore. Nuk kemi ndonjë çështje për të ngritur në këtë fushë.

### 4.5.3 Subvencionet dhe Transferet

#### Përshkrimi

Buxheti i planifikuar për këtë kategori ishte 206,947€ ndërsa shpenzimi 204,581€. Ne kemi testuar 14 mostra në shumë 20,652€.

Auditimi ynë është fokusuar në rishikimin e procesit të dhënies së subvencioneve dhe testet tona në këtë kategori nuk kanë identifikuar ndonjë dobësi domethënëse.

## 4.6 Pasuritë dhe detyrimet

### 4.6.1 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

#### Përshkrim

Vlera neto e pasurisë së regjistruar në SIMFK për vitin 2013 është 279,277,297€ që krahasuar me vitin 2012 ishte 277,653,315€.

---

#### Çështja 15 - Regjistri i pasurive jo i besueshëm - Prioritet i lartë

**E gjetura** Komuna për vitin 2013 e kishte hartuar më vonesë raportin për inventarizim të pasurisë. Komisioni për inventarizim ishte themeluar në Nëntor 2013, derisa ky komision raportin e kishte hartuar më 24.03.2014.

**Rreziku** Mos përfshirja e rezultateve të regjistrimit që kishte rezultuar nga komisioni për inventarizim si dhe mungesa e barazimeve me regjistrat kontabël, paraqet rrezik që vlera e pasurisë e prezantuar në PVF të mos jetë e plotë dhe e saktë.

**Rekomandimi 15** Kryetari duhet të siguroj që raporti i komisionit për vlerësim dhe inventarizim të pasurive është shqyrtuar dhe rezultatet e regjistrimit janë përditësuar në regjistrat e pasurive. Diferencat e regjistrimeve dhe regjistrave kontabël duhet të sqarohen, kurse pasuria e pa përdorshme, e tjetërsuar, e shitur apo jashtë përdorimit, duhet gjithashtu të trajtohet sipas Udhëzimeve mbi përdorimin e pasurisë qeveritare.



## 4.6.2 Trajtimi i borxheve

### Përshkrim

Pasqyra e detyrimeve të papaguara ndaj furnizuesve në fund të vitit 2013 ishte 114,218€. Këto detyrime janë bartur për t'u paguar në vitin 2014. Megjithatë, kjo pasqyron vetëm një pjesë të prezantimit të obligimeve nga ana e komunës. Në testuam 25 mostra lidhur me regjistrimin dhe raportimin e obligimeve dhe identifikuam mangësitë si më poshtë:

---

### Çështja 16 – Raportim i Obligimeve - Prioritet i mesëm

**E gjetura** Regjistri i obligimeve të papaguara të raportuara në PVF nuk është i saktë për faktin se faturat në vlerë prej 11,994€ nuk ishin shpalosur në PVF e vitit 2013 si obligime të papaguara.

**Rreziku** Mos raportim i saktë i obligimeve në PVF-të rezulton që shpalosjet e obligimeve në PVF-të të mos jenë të plota dhe të besueshme. Kjo gjithashtu rritë rrezikun potencial që të bëhen pagesa të dyfishta.

**Rekomandimi 16** Kryetari duhet të siguroj kontrolle të vazhdueshme në procesin e mbajtjes së evidencave për obligimet e komunës në mënyrë që në PVF-të e komunës të shpaloset një gjendje e saktë dhe e plotë e obligimeve të komunës.

## 4.7 Sistemi i auditimit të brendshëm

### Përshkrimi

Njësia e Auditimit të Brendshëm përbëhet vetëm nga një auditor që gjithashtu është edhe drejtor i NJAB-it. Kjo njësi kishte planifikuar t'i kryej gjashtë auditime për 2013 dhe kishte kryer të gjitha auditimet e planifikuara. NJAB-i për vitin 2013 kishte bërë vlerësime mbi aplikimin e kontrolleve të brendshme nga menaxhmenti dhe kishte ofruar këshilla dhe rekomandime të dobishme për përmirësimin e kontrolleve. Puna e NJAB-së mbulonte aktivitetet e vitit 2013. Raportet e kësaj njësie ishin të një niveli të kënaqshëm.

Komuna kishte një komitet të auditimit, mirëpo ai nuk ishte funksional, si rezultat i kësaj në dhjetor të vitit 2013, kryetari kishte caktuar një komitet të ri të auditimit.

---

### Çështja 17 – Mos funksionalizimi i Komitetit të Auditimit- Prioritet i lartë

**E gjetura** Komiteti i auditimit të brendshëm ishte pothuajse jo funksional. Ky komitet gjatë vitit 2013 drejtohet nga një anëtar ekzekutiv i komunës, i cili ishte drejtor i financave. Drejtimi i Komitetit të Auditimit nga një anëtar ekzekutiv i komunës është në kundërshtim me udhëzimin administrativ 11/2010. Procesverbalet e takimeve të rregullta të komitetit nuk ishin të nënshkruara nga anëtarët e komitetit të auditimit.

**Rreziku** Mos funksionimi i komitetit të auditimit dhe mos përgatitja e planeve të veprimt nga disa njësi të caktuara për auditimin e brendshëm, nuk ofron sigurinë se rekomandimet e auditimit të brendshëm po zbatohen nga ana e menaxhmentit.

**Rekomandimi 17** Kryetari duhet të funksionalizoj komitetin e auditimit dhe të siguroj që çështjet e ngritura nga auditimi i brendshëm të adresohen nga menaxhmenti në mënyrë që gabimet dhe parregullsitë të zvogëlohen.

## Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZAP

(e shkëputur nga ISSAI 200)

### Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë anomali materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë anomali materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

### Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinion në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë anomali materiale. Auditorët mund të japin tre lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- Natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë anomali materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë anomali materiale; dhe
- Gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se anomalitë, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se anomalitë, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban anomali materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragrafi të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i Theksimit të Çështjes duhet:

- Të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- Të ketë titullin 'Theksim i Çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- Të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- Të tregoj se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes së theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjera", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

## Shtojca II: Rekomandimet e vitit paraprak

Komponenti i Auditimit	Rekomandimet e dhëna	Rekomandimet plotësisht të adresuara	Rekomandimet pjesërisht të adresuara	Rekomandimet e pa adresuara
1.Zbatimi i rekomandimeve	Të siguroj që komuna të përgatisë planin e veprimit me staf llogaridhënës në fushat të rëndësishme të madhe.	Po		
2.Te hyrat vetjake	Trajtimi i të hyrave, vendosja e mekanizmave efektiv për realizimin e të hyrave dhe rivlerësimin e vjetërsisë së të llogarive të arkëtueshme si dhe gjetjen e mundësive reale të inkasimit.			Jo
3. Të hyrat	Mbledhja e mjeteve dhe depozitimi në llogari bankare.	Po		
4. Shpenzimet / pagesa nga kodet adekuate.	Të siguroj që të gjitha shpenzimet të bëhen nga kode adekuate .			Jo
5.Shpenzimet	Mbikëqyrja e projekteve me bashkëfinancim			Jo
6.shpenzimet	Të siguroj procedura të kontrollit në rastin e pranimin të punimeve.	po		
7.Shpenzimet	Të siguroj që zyrtari për financa të bëjë klasifikimin e duhur të shpenzimeve			Jo

8.Përzgjedhja e OE	Të siguroj që depo i prokurimit ka ndjekur të gjitha procedurat e duhura të vlerësimit me rastin e përzgjedhjes së OE		Po	
9.Sigurimi i ekzekutimit	Të respektohen kërkesat e dosjes së tenderit lidhur me sigurinë e ekzekutimit	po		
10.Personel	Të siguroj që dosjet e personelit të jenë të azhurnuara	po		
11.Subvencionet	Të siguroj që vendosjen e procedurave të kontrollit lidhur me ndarjen e subvencioneve si dhe të bazohet në rregulloren e brendshme		Po	
12.Inventarizimi i pasurive	Te sigurohet që raporti i inventarizimit të pasurisë të përfundohet me kohë.			Jo
13.Menaxhimi i Pasurisë	Të siguroj që të gjitha pasuritë të regjistrohen konform udhëzimit administrativ për menaxhimin e pasurive			Jo